



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dop. Dep.	D-P
Nr. Prot. B. Prot. Prot. No.	03-3291/1
Nr. f. sh. Broj. stranica Nr. pages	01
Data Datum Date	22.07.2011
PRISHTINE	



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U  
PRIŠTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj:17125/2010

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Vilson Mirdita – ambasador i Republikës së Kosovës në Gjermani, për kundërvajtje nga neni 6 pika 1 dhe 2 e konform neni 6 pika 6 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publikë, e në bazë të neni 73, 74, dhe neni 198 al.1 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më datë 28.06.2011 merr këtë:

### AKTVENDIM

**PEZULLOHET** procedura kundërvajtëse ndaj të pandehurit Vilson Mirdita ,ambasador i Republikës së Kosovës në Gjermani, për kundërvajtje nga neni 6 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publikë. Procedura **pezullohet** konform neni 198 al.1 pika 8 të Ligjit Mbi Kundërvajtjet, pasi që nuk ka prova se i pandehuri e ka kryer kundërvajtjen e cila me kerkese i vihet në barre. Nga një kopje e këtij aktvendimi t’i dërgohet të pandehurit dhe parashtresit të kërkesës.

### Arsyetim

- Agjensia Kunder Korrupsionit, parashtroi kërkesën me nr. 0122782278/2010 të dt. 16.06.2010 për fillimin e procedurës së kundërvajtjes kundër pandehurit të cekur më lartë dhe për kundërvajtjen e përshtuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Në bazë të të dhenave në kerkese, shqimit të shkresave të lendes dhe provave tjera të administruara gjatë procedurës, gjyqtarja konstatoi se i pandehuri nuk është përgjegjës për kundërvajtjen e cila me kerkese i vihet në barre, pasi që i njëjti e ka bërë deklarin e pasurisë me datën 26.03.2010 qka shihet në bazë të shkresave të lendes ,mirpo Ministria e Punëve të Jashtme ,nuk e ka bërë dorëzimin e formularit për deklarin e pasurisë në afatin e parapare ligjor në Agjensinë Kunder Korrupsionit, andaj konform neni 6 pika 6 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe neni 198 al.1 pika 8 të LMK-së, PEZULLOHET procedura kundërvajtëse ndaj të pandehurit pasi që nuk ka prova se i pandehuri e ka kryer kundërvajtjen e cila me kerkese i vihet në barre. Me sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, ankesë mund të parashtrojë i pandehuri dhe parashtresi i kërkesës, Gjykates së Lartë për Kundërvajtje, në afatin prej 8 ditësh, pas marrjes së këtij aktvendimi, nëpërmes kesaj gjykate dhe pa taksa.

**VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**

Gjyqtarja  
Zajrete Muhaxheri

